



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:047340

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05697450

KPPP.nr. 294/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbaremore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë–Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, kundër debitorit Radio Televizioni i Kosovës SH.A., me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr. 1064/2023 të datës 21.12.2023, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Irfan I. Kërçagu, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 16.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Radio Televizioni i Kosovës SH.A., ndërsa Urdhri Përmbaremore P.nr. 1064/2023 i datës 21.12.2023, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Irfan I. Kërçagu, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë–Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në bazë të dokumentit përmbareues - Vendimit Nr. 01/56-168/2023 GJ i datës 19.07.2023 ka caktuar zbatimin e përmbaremit përmes urdhrit përmbaremore P.nr. 1064/2023 të datës 21.12.2023 ndaj debitorit Radio Televizioni i Kosovës Sh.a, të cilin e ka detyruar që në emër të masës ndëshkimore të shqiptuar sipas aktvendimit të lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën e borxhit prej 1,500.00 EUR, në afat prej 7 ditësh, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë me ndalim të mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe në shitje të sendeve të luajtshme pronë e debitorit, si dhe t’i paguaj shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se dokumenti në bazë të cilit është marrë urdhri përmbarues nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, pasi që dokumentet në fjalë të cilat janë vendimet e Inspektoratit të Punës, dëshmojnë se të njëjtat janë në kundërshtim me kërkueshmërinë e përmbarimit pa marrë parasysh se një gjë e tillë parashihet me nenin 71 par.1.1. të LPP-së. Pastaj ka shtuar se përmbaruesi ka lëshuar urdhrin përmbarimor pa u plotësuar kushtet për nxjerrjen e tij, në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi që është paraqitur padi dhe nuk është marrë ende një aktvendim sa i përket gjobës së shqiptuar nga ana e kreditorit. Andaj ka kërkuar nga Gjykata që të pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të pezullohet Urdhri për Përmbarim P.nr. 1064/23 i datës 21.12.2023 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Irfan I. Kërçagu.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Vendimin Nr. 01/56-168/2023 GJ të datës 19.07.2023, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 par. 1, nën-par. 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla, dhe i cili vendim i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata tutje vlerëson se Vendimi Nr. 01/56-168/2023 GJ i datës 19.07.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara edhe në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues,*

original apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”, ngase aktvendimi i lartcekur është i pajisur me klauzolën e përmbarueshmërisë nga e cila rezulton se i njëjti është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me datë 14.09.2023.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përmbarues, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore, prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Po ashtu lidhur me pretendimet se ndaj vendimit të lartcekur ka parashtruar padi në procedurën e konfliktit administrativ, të njëjtat janë të pabazuara ngase padia e paraqitur në gjykatë nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e vendimit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, kjo në kuptim edhe të dispozitës nga neni 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative, me të cilin përcaktohet se *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”*.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 294/24, datë 16.05.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.